

# RIEM SH.P.K

## Statut i Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dl. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", -  
"Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më date 26 tetor 2022 , ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin 'RIEM' SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

- Rigel Kujtim Krasta , shtetas Shqiptar, lindur në Corovode, me 09/09/1996 , madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me nr.pasaportës BD6808815.
- Emanuela Vlash Cara , shtetase Shqiptare , lindur në Lezhe, me 11/10/1995, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar , me nr.letërnjoftim 032542657.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Objekti I shoqërisë është: Kryerja dhe menaxhimi I transaksioneve monetare, si dhe kembimeve valutore si agjent I shërbimeve të ofruara në pikat money gram dhe exchange .

Objekti I shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të ortakëve.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jete me nje afat te pacaktuar .

Neni 4:

Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

Rruga Spiro Floqi ,Pallati Ajazi, kati perdhe , Astir , 1001 Tirane,Albania. ..

Kreu I Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 Lekë . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Rigel Krasta : Zoterues i I (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5.100 Lek që përben 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë

2.Ortaku themelues Emanuela Cara : Zoterues i I (një) kuote me vlerë të përgjithshme

4.900 Lek që përben 49<sup>0</sup>/0 të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga giykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës se administrator.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

1. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
2. shitblerjes;
3. trashëgimisë',  
ç) dhurimit;
4. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU 111

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit;
3. emerimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
4. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike; dli) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

5 .miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve te ecurisë se veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

6.pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre•,

7.përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

8.miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë•,

9.çështje të tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve ne asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm per një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e Cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9

##### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, daten, orën e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo me vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës I të këtij neni, ajo mund te marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavaresisht parregullsisë.

#### Neni 10 Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumice të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nese marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë per çështje, te cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare <sup>SI</sup>, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë. apo mjete elektronike. sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 te këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë. me të njëjtin rend dite.

#### Neni 11

##### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, per ndryshimin e statutit, zmadhimin Ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, Për çështje te tjera si .

1. përcaktimi i politikave tregtare te shoqërisë;

2. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

3. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar:

ç) përcaktimin e shpërblimeve

4. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

5. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

6. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirja nga e drejta e votës

I .Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

1. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
2. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
3. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;

ç) dhënien Ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi. ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(I) Asambleja e përgjithshme emëron një Ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. A fati i ernërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

1. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
2. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:

1. Emanuela Vlash Cara
2. Rruga blv migjeni , kompleksi molla , pallati 124 ,seksioni 1, shkalla 2 , hyrja 7 .

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe. së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente per-para asamblesë së përgjithshme për miratim;

4. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat. që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

5. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithëshme. në rastet kur: -sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare. rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 per qind të asetëve të shoqërisë. që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 per qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë,

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padiç, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

#### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

I . a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

1. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

2. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

3. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

1. Administratori, gjatë klyerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve perkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
  2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave I e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personal e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
  3. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
    1. u kthen ortakëve kontributet;
    2. u paguan ortakëve interesa apo dividendë; 3. u shpërndan aktivet shoqërisë;
 ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  4. jep kredi.
- Perveç padise për shlyerjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
- Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të demit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblese nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padise kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyres.

#### Kreu IV Viti financiar-ekspertet

##### Neni 16

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kornbetare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

##### Neni 17

##### Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me

kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te fille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimnore qe ka.

## Kreu V Prishja —riorganizimi i shoqerise

### Neni 18

#### Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe .I

.kur mbaron kohözgiatja e parashikuar ne themelimin e sağ

2. me vendim te Asamblese se Ortakeve;

3. me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne përputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";

4. me vendim te gjykates•.

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar I apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi layhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve. brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### Neni 19 Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara ne Pjesën

Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

### Neni 20

#### Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21 Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**O R T A K E T**  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

(Emer ,mbiomer,nenshkrimi)

Emanuela Sara  


(Emer,mbiomer, nenshkrimi)

Rigel Krasta  
